

BAHRI BECI

FLASIM DHE HARTOJMË NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 5
për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2009

Dr. Bahri Beci

FLASIM DHE HARTOJMË NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 5

për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT

ГОВОРИМО И САСТАВЉАМО УПОЗНАЈЕМО ЈЕЗИК

АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 5

за пети разред основне деветогодишње школе

ПРИРУЧНИК

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Redaktor: Zarija Brajoviq

Recensentë: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Artan Haxhi
Qamil Maraj, mësues i lëndës mësimore
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof. dr. Vehbi Hoti, psikolog

Disenjoja dhe faqosja: Sasha Protiq

Korrektor: Rrok Gjolaj

Redaktor teknik: Rajko Radulloviq

Për botuesin: Nebojsa Dragoviq

Shtypur në Studio "Mouse"; Podgoricë

Tirazhi: 50

ISBN: 978-86-303-1417-9

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3-153 të datës 31. 08. 2009 e ka miratuar këtë komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRA E LËNDËS

Struktura dhe përmbajtja e librit.....	4
Ecuria metodike për realizimin e synimeve	7

KAPITULLI I PARË

1. Bisedat zyrtare dhe jozyrtare	8
2. Fjalitë sipas kuptimit, formës dhe ndërtimit.....	9
3. Funkzioni i fjalëve në fjali.....	11
4. Njoftimet publike	12

KAPITULLI I DYTË

1. Përshkruajmë bimët	13
2. Përshkruajmë kafshët.....	14
3. Emrat e lëndës dhe përmbledhës.....	16
4. Gjinia dhe numri i emrave	17
5. Gjinia dhe numri i mbiemrave	18
6. Shkallët e mbiemrit	19

KAPITULLI I TRETË

1. Koha e shkuar, e tashme dhe e ardhme e foljeve	20
2. Përshkruajmë një krahinë.....	22
3. Përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm.....	23
4. Shkurtime.....	24

KAPITULLI I KATËRT

1. Përemrat vetorë.....	25
2. Përshëndetja zyrtare dhe jozyrtare	26
3. Urimi zyrtar dhe jozyrtar	27
4. Ftesa zyrtare dhe jozyrtare	28
5. Letra personale dhe publike	29

KAPITULLI I PESTË

1. Flasim për gjuhën	30
2. Shkrimi i emrave të ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve.....	31
3. Numërorët.....	32
4. Anketa.....	33
5. Shkrimi i titujve të librave, të revistave dhe të gazetave	34

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E LIBRIT

Teksti mësimor “Flashim dhe hartojmë. Njohim gjuhën” është vazhdim i drejtpërdrejtë i teksteve “Valle tingujsh dhe shkronjash 1 2” dhe “Valle fjalësh e fjalish 3 4” dhe ka synime të qarta për ta përvetësuar mësimin e gjuhës amtare përmes të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Ndryshon prej tyre në strukturë, për shkak të ndryshimit të vetë përmbajtjes së mësimin të gjuhës amtare në klasën e pestë, që shënon edhe një etapë të re në ciklin e dytë që ka si synim rritjen e mëtejshme të aftësive për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar.

Kjo duhet të bëjë të mundur që pas përfundimit të shkollës nëntëvjeçare nxënësit aftësohen për të dëgjuar me vëmendje, për të folur mirë, bukur dhe saktë dhe në përpunje me situatën, për të lexuar tekste letrare dhe joletrare

Njohja e veçorive të sistemit të gjuhës letrare shqipe, në këtë klasë të ciklit të dytë, ashtu si edhe në klasën e katërt, edhe pse zë një vend më të dukshëm se në ciklin e parë, do të vazhdojë të konceptohet si praktikë gjuhësore. Pra, edhe në këtë nivel shkollimi, mësimi i gjuhës amtare është kryesisht praktikë gjuhësore.

Në *Tekstin mësimor* dhe në *Fletoren e punës* ekzistojnë pesë kapituj në të cilët janë parashtruar përmbajtjet e parashikuara me Programin e lëndës mësimore.

Kapitulli i parë

Në kapitullin e parë trajtohen veçoritë e bisedave zyrtare dhe jozyrtare, veçoritë e njoftimeve publike dhe jopublike. Lidhur me këto tematika bëhen objekt shqyrtimi tekste bisedash zyrtare dhe jo zyrtare si edhe tekste joletrare të tilla, si: *Historia e kukullave, Numërori telefonik, Orari i trenave, Programi i televizionit, Parashikimi i motit*, Përmbajtja e njohurive për sistemin gjuhësor paraqitet si vazhdim e thellim i njohurive të fituara deri në klasën e katërt. Problemet që trajtohen janë: llojet e fjalive sipas kuptimit (dëftore, pyetës, nxitëse), formës (pohore dhe mohore) dhe ndërtimit (të thjeshta dhe të zgjeruara), funksioni i fjalëve në fjali (kryefjala, kallëzuesi, rrethanorët)

Kapitulli i dytë

Ky kapitull i kushtohet kryesisht leximit dhe analizës së teksteve joartistike (mbi bimët, kafshët, qumështin, ajrin, atmosferën, liqenin e Ohrit etj.). Nxënësit do të fitojnë shprehitë e leximit të teksteve joletrare shkencore, si edhe të dallojnë në to konceptet kryesore dhe të dhënat më të rëndësishme. Po kështu, do të aftësohen të krijojnë vetë tekste të ngjashme duke u mbështetur në një skicë-ide të përgatitur më parë. Përmes këtyre mësimëve, synohet gjithashtu që nxënësit të ushtrohen për të kërkuar e gjetur në mënyrë të pavarur të dhëna nga revista, tekste, enciklopedi etj.

Në këtë kapitull, nxënësit do të përsëritin llojet emrave (të përveçëm dhe të përgjithshëm, përmbledhës dhe të lëndës), gjininë dhe numrin e emrave, mbiemrat, gjininë dhe numrin e tyre, shkallët e mbiemrit.

Kapitulli i tretë

Kapitulli e tretë përmban tekste joartistike, si: përshkrime të një krahine (Mali i Zi) a zone (Krahina e Rijekës) etj. Pra, edhe në këtë kapitull nxënësit do të ushtrohen të dëgjojnë, të lexojnë, të analizojnë dhe të krijojnë tekste joartistike.

Për sa u takon njohurive për sistemin gjuhësor, nxënësit do të përsëritin kohët e foljes (e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja), rregullat e drejtshkrimit të emërtimeve të fshatrave, të qyteteve dhe të shteteve dhe shkurtimet e fjalëve.

Kapitulli i katërt

Kapitulli i katërt i kushtohet dallimit të përshëndetjeve, urimeve dhe ftesave zyrtare e jozyr-

tare, kujt i drejtohen dhe cilat janë veçoritë e hartimit të tyre.

Në fushën e njohurive gramatikore, do të shqyrtohen përemrat vetorë, si edhe shkrimi i përemrit Ju kur i drejtohem me respekt një personi .

Kapitulli i pestë

Në kapitullin e pestë, do të njihen me anketën si një lloj i ri i tekstit joartistik dhe do të aftësohen të paraqesin në mënyra të ndryshme rezultatet e anketës. Do të rimerret problemi i gjuhës letrare dhe do të njihen me disa të dhëna për gjuhën në përgjithësi, familjet gjuhësore dhe për gjuhën shqipe në veçanti.

Në fushën e njohurive për sistemin gjuhësor, do të njihen me numërorët si një lloj i veçantë i fjalëve. Në fushën e drejtshkrimit do të mësojnë rregullat e drejtshkrimit të numërorëve, të emërtimeve të veprave letrare, të revistave dhe të gazetave, si edhe të institucioneve, të organizatave dhe të ndërmarrjeve. Do të lexojnë dhe do të analizojnë tekstet joartistike.

Nxënësit i formojnë njohuritë e tyre përmes veprimtarive vetjake, kështu që në qendër të të gjithë procesit mësimor duhet të jenë nxënësit, të cilët përmes veprimtarive mësimore, nën drejtimin e mësuesit, i zbulojnë vetë njohuritë e reja.

Gjatë kërkimit të teksteve kemi pasur parasysh që të zgjedhim tekste me tematikë të përshtatshme, për aftësitë e tyre njohëse dhe interesante për moshën e tyre. Po qe se tekstet e zgjedhura ju i gjykoni se duhen redaktuar nga kjo ose ajo pikëpamje, ju mund ta bëni këtë, po duhet të ruani të dhënat. Tekstet janë nxjerrë nga enciklopeditë për fëmijë, interneti etj. Kur e kemi gjykuar të nevojshme tekstet i kemi modifikuar e përshtatur.

Pas çdo teksti vijnë pyetjet që ju japin mundësi të punoni për zhvilluar më tej tek fëmijët aftësinë për të analizuar dhe kuptuar tekste joletrare. E rëndësishme gjatë analizës së teksteve është që nxënësit/et jo vetëm të kuptojë përmbajtjen ose idenë kryesore të tekstit, po të dinë edhe ta ndajnë tekstin në pjesët e tij përbërëse dhe të kuptojnë lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.

Synimi përfundimtar i tërë punës me leximin është që nxënësit të arrijnë ta kuptojnë mirë tekstin dhe ta mbajnë mend. Para fillimit të analizës së një teksti joletrar duhet të pyesim nxënësit t'u se çfarë dinë ata për problemin që trajtohet në tekstin që do të lexohet. Mund të shkruani në tabelë ato që thonë fëmijët. Pas kësaj mund t'i grupojmë pohimet e tyre sipas një kriteri logjik në disa të dhëna, kategori ose aspekte themelore.

Kjo u jep mundësi nxënësve të dallojnë të dhënat kryesore nga ato jo kryesore dhe t'i rendisin ato në mënyrë logjike, çka lehtëson kuptimin dhe mbajtjen mend të tekstit në përgjithësi.

Duhet pasur kujdes që gjatë analizës së teksteve të krijohet ekuilibri i nevojshëm ndërmjet të katër veprimtarive themelore që janë të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Për ta bërë mësimin interesant dhe për ta lidhur më mirë me aktualitetin, rekomandohet që mësuesi, sipas vlerësimeve të tij, ta pasurojë orën e mësimimit me tekste nga aktualiteti me interes për fëmijët e kësaj moshe.

Punët me shkrim janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit mësimor në klasën e pestë. Ato duhen kuptuar si një mjet komunikimi i fëmijës me të tjerët. Prandaj është e rëndësishme që t'u jepen mundësitë fëmijëve ta përdorin e përsosin gradualisht këtë mjet shumë të rëndësishëm të komunikimit.

Mësuesi ka për detyrë t'i nxitë e inkurajojë vazhdimisht nxënësit në këtë drejtim. Është një rast për të provuar e verifikuar veten, aftësitë e tij për të dhënë një përmbajtje të caktuar, për të parashtruar ide, për të shkruar me një gjuhë të saktë nga ana gramatikore e drejtshkrimore, për t'u paraqitur para një opinionin të caktuar shoqëror. Në këtë mënyrë, u krijojmë mundësi fëmijëve që, në këtë moshë, të shkruajnë për publik, pra, të përgatiten si krijues.

Kjo është një punë që do të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të tyre, po bazat e këtij formimi fillojnë që në këtë moshë, prandaj duhet vlerësuar e mbështetur me të gjitha mundësitë.

Në këtë mënyrë, ju edukoni tek fëmijët dashurinë për shkrimin dhe do t'i aftësoni ta kuptojnë atë si burim kënaqësie e mjet komunikimi.

Duhet të bisedoni me fëmijët para se të fillojnë të shkruajnë, t'u bëni pyetje për përmbajtjen e asaj që do të shkruajnë, për të dhënat kryesore që do të paraqesin, për zhvillimin e ngjarjeve

etj. Edhe pas variantit të parë të shkrimit duhet të bisedoni me to, t'i ndihmoni të gjejnë mungesat, gabimet dhe t'i ndreqin ato vetë.

Ju do t'i hartoni vetë testet të cilat do të bëhen në fund të çdo pjese dhe në përfundim të lëndës për verifikimin e njohurive të fituara dhe shkallën e përvetësimit. Për testet mund të udhëhiqeni nga tipat e ushtrimeve të parashtruara në *Fletoren e punës*, po jeni të lirë të shkoni edhe më tutje në vartësi të veçorive të përvetësimit të lëndës nga nxënësit e klasës suaj. Po kështu, është e drejtë e juaj të përcaktoni përmbajtjen edhe mënyrën e realizimit të një projekti të caktuar në përputhje me tematikën e mësimeve dhe interesin e nxënësve. Për këtë duhet të përcaktohet tema, grupet e punës dhe veprimtaritë e secilit prej tyre.

Fletorja e punës është konceptuar në mënyrë të tillë që, pas punës me *Tekstin mësimor*, të thellojnë më shumë njohuritë e fituara në të dhe të zhvillojnë të menduarit logjik dhe krijues të nxënësit. Jemi përpjekur të japim tipa të ndryshëm detyrash, tekste të reja, për t'u dhënë mundësi kreativitetit dhe punës së pavarur në arritjen e objektivave të parapara me Program. Tërësia e pyetjeve parasheh kërkesa minimale dhe mesatare, detyrat janë konceptuar nga më e lehta tek më e vështira.

Që të shfrytëzohen në mënyrë më funksionale *Teksti mësimor* dhe *Fletorja e punës*, është përgatitur edhe *Manuali* për mësuesin. Kjo pjesë e materialit mësimor paraqet mënyrën e realizimit të përmbajtjes mësimore.

Në të vërtetë, ne mendojmë se i duhet lënë mësues-it/-es e drejta për të vendosur përfundimisht për përcaktimin e orëve për çdo njësi mësimore dhe për realizimin konkret metodik të çdo ore mësimi në përputhje me veçoritë e klasës së tij dhe të stilit tij të punës.

**ECURIA METODIKE PËR REALIZIMIN
E SYNIMEVE**

1. Bisedat zyrtare dhe jozyrtare

Synimi: të dëgjojnë nxënësit biseda të incizuar dhe të lexuara, të zhvillojnë shkathtësinë e dëgjimit dhe të leximit të teksteve joartistik, të kuptojnë tekstin e dëgjuar ose të lexuar, të gjejnë temën, fjalët kryesore, të dhënat e rëndësishme, të zhvillojnë aftësinë e dallimit të bisedave zyrtare nga ato jozyrtare, të aftësohen të zhvillojnë biseda të tilla.

Janë të nevojshme : dy biseda, një jozyrtare dhe një zyrtare të regjistruara në magnetofon.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të dëgjojnë bisedat e regjistruara në magnetofon;
- bën pyetje për përmbajtjen e tyre dhe u kërkon të argumentojnë me të dhëna nga teksti nëse janë jozyrtare ose zyrtare;
- i fton të lexojnë tekstin A në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: Kush janë bashkëbiseduesit? Si përshëndeten? Me kë përshëndeteni ju në këtë mënyrë? Pse? Cila është tema e bisedës së tyre?;
- i fton të lexojnë tekstin B në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: Kush janë bashkëbiseduesit? Si përshëndeten ata? Si i drejtohen njëri-tjetrit? Kujt i drejtohesh me Ju? Cila është tema e kësaj bisede?;
- i fton të lexojnë në Librin e nxënësit tekstet A e B që vijojnë;
- bën pyetjet: Çfarë janë këto dy tekste? Si e nxorët përfundimin që janë biseda? Kush janë bashkëbiseduesit në tekstin A? Si përshëndeten? Pse nuk janë prezentuar bashkëbiseduesit? Cila është tema e bisedës në tekstin A? Si përshëndeten bashkëbiseduesit në tekstin B? Pse përshëndeten kështu? Cila është tema e bisedës në tekstin B? Në cilin prej dy teksteve bashkëbiseduesit i drejtohen njëri-tjetrit me Ju? Përse?;
- nxjerrin përfundimin që bisedat janë zyrtare dhe jozyrtare, që bisedat zyrtare zhvillohet zakonisht ndërmjet dy personave që nuk njihen, që ato fillojnë dhe mbarojnë zakonisht me përshëndetjet: **mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbrëma, mirë u pafshim, natën** e mirë etj., që në fillim të bisedave zyrtare, nëse është e nevojshme, personat prezantohen, që gjatë bisedës zyrtare bashkëbiseduesit i drejtohen njëri-tjetrit me Ju, që gjuha është më e zgjedhur, që bisedat jozyrtare zhvillohen zakonisht ndërmjet dy personave që njihen (miq, të njohur, kushërinj, moshatarë etj.), që ato fillojnë dhe përfundojnë zakonisht me përshëndetjet çao, tungjatjeta, që në bisedat jozyrtare bashkëbiseduesit nuk prezentohen dhe nuk i drejtohen njëri-tjetrit me Ju, që gjuha është e çlirët;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

2. Fjalitë sipas kuptimit, formës dhe ndërtimit

Synimi: të dallojnë dhe të emërtojnë nxënësit në tekst fjalinë e thjeshtë dhe të zgjeruar, fjalinë dëftore, pyetëse dhe nxitëse, formën pohore dhe mohore të fjalisë, të zhvillojnë aftësinë e leximit të teksteve joartistike, të kuptojnë tekstet e lexuara, të përcaktojnë temën, fjalët kryesore, të gjejnë të dhënat e rëndësishme, të aftësohen të dallojnë fjalitë sipas kuptimit, formës dhe ndërtimit, të aftësohen t'i përdorin ato në të folurit e përditshëm dhe në shkrim, të zhvillojnë aftësitë për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *bën pyetjet : Çfarë është fjalia dëftore? Çfarë është fjalia pyetëse? Çfarë është fjalia nxitëse? dhe organizon diskutimin për këtë problematikë;*
- *i pyet në se ata e dinë, se sa të vjetra janë kukullat;*
- *u kërkon të lexojnë tekstin “Historia e kukullave”;*
- *bën pyetjet : Për çfarë flitet në këtë tekst? Si ishin kukullat në kohën e egjiptianëve? Si ishin kukullat me të cilat luanin vajzat greke? Po vajzat romake me çfarë kukullash luanin? Po sot, prej çfarë materiali bëhen kukullat? Cila është kukulla që ju pëlqeni më shumë? Pse?;*
- *u kërkon të lexojnë tekstin në vijim;*
- *bën pyetjet: Përse shërben fjalia e parë? Çfarë po bëjnë vajzat? Çfarë shenje pikësimi ka në fund? Çfarë fjalie është? Po fjalitë: Vajzat po luajnë me kukullën Barbi. - Është ora për të fjetur. Nuk është ora për të luajtur., përse shërbejnë? Çfarë shenje pikësimi kanë në fund? Çfarë fjalish janë? Po fjalia: Thirri. përse shërben? Çfarë shenje pikësimi ka në fund. Çfarë fjalie është? Po fjalitë e tjera çfarë fjalish janë? dhe u kërkon ta argumentojnë;*
- *nxjerrin përfundimet që fjalitë për nga kuptimi mund të jenë **dëftore, pyetëse** dhe **nxitëse**, që fjalia dëftore shërben për të treguar diçka, që fjalia pyetëse shërben për të pyetur për diçka, që fjalia nxitëse shërben për të nxitur dikë për të bërë diçka;*
- *bën pyetjet: Çfarë është fjalia pohore? Çfarë është fjalia mohore? dhe organizon diskutimin për këtë problematikë;*
- *i fton të lexojnë fjalitë pohore dhe mohore në vijim;*
- *u kërkon të shpjegojnë se pse mbi fjalitë e kolonës së parë është shkruar: fjali pohore, kurse mbi fjalitë e kolonës së dytë është shkruar : fjali mohore;*
- *nxjerrin përfundimin që fjalitë për nga forma mund të jenë pohore dhe mohore, që fjalitë pohore pohojnë diçka, kurse fjalitë mohore mohojnë diçka;*
- *bën pyetjet: Çfarë është fjalia e thjeshtë? Çfarë është fjalia e zgjeruar?;*
- *u kërkon të lexojnë e krahasojnë në Librin e nxënësit dy fjalitë në vijim;*
- *bën pyetjet: Cila fjalë kryen shërbimin e kryefjalës në fjalinë e parë? Po të kallëzuesit? Çfarë fjalie është kjo fjali për nga ndërtimi? Pse? Cila është kryefjala dhe cili është kallëzuesi në fjalinë e dytë? Përveç kryefjalës e kallëzuesit çfarë fjalësh të tjera ka në fjalinë e dytë? Me cilën fjalë lidhen? Çfarë fjalie është?;*
- *nxjerrin përfundimin që fjalitë për nga ndërtimi mund të jenë të thjeshta dhe të zgjeruara, që fjalia e thjeshtë përbëhet nga kryefjala dhe kallëzuesi, që fjalia e zgjeruar përveç kryefjalës e kallëzuesit ka edhe fjalë të tjera;*
- *u kërkon të lexojnë tekstin (dialogun) në vijim;*
- *bën pyetjet: Çfarë teksti është ky? Ç’lloj fjalish janë për nga kuptimi fjalitë këtij teksti? Po për nga ndërtimi çfarë fjalish janë?;*
- *u kërkon t'i shkruajnë ato në fletoren e tyre në formën mohore, të gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin dhe fjalët ose togfjalëshat që tregojnë vendin dhe mënyrën e*

1 Kapitulli i parë

veprimet të foljes;

- *u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

3. Funkzioni i fjalëve në fjali

Synimi: të dallojnë dhe të emërtojnë nxënësit kryefjalën e kallëzuesin dhe fjalët që i përcaktojnë ato, të gjejnë kryefjalën, kallëzuesin dhe fjalët që i përcaktojnë ato, të dinë të lidhin llojin e fjalëve me funksionin që kryejnë ato në fjali, të zhvillojnë aftësinë për të lexuar tekste joartistike, të kuptojnë tekstin e lexuar, të gjejnë temën, fjalët kryesore, të dhënat e rëndësishme.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *bën pyetjet: Çfarë tregon kryefjala? Çfarë tregon kallëzuesi? Çfarë janë pjesët plotësuese? dhe organizon diskutimin lidhur me këtë tematikë;*
- *u kërkon të lexojnë fjalinë: **Në mëngjes fëmijët bisedonin qetësisht në oborrin e shkollës.**;*
- *u kërkon të gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin e kësaj fjalie dhe bën pyetjet: Cilat fjalë tregojnë kohën e kryerjes së veprimit të foljes? Me ç'pyetje gjenden ato? Cilat fjalë në fjali tregojnë vend? Me çfarë pyetjesh gjenden ato? Çfarë tregon për veprimin fjala qetësisht? Si quhet ky rrethantor? Cilës pyetje i përgjigjet ai?;*
- *nxjerrin përfundimet që fjalët dhe grupet e fjalëve që tregojnë vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprimit janë **rrethantorë**, që rrethantorët mund të tregojnë vend, kohë, mënyrë etj., që rrethantorët e vendit, të kohës dhe të mënyrës gjenden përkatësisht me pyetjet ku, kur, si;*
- *i fton të lexojnë fjalinë: **Fëmijët e klasës sonë luajnë në oborrin e shkollës.**;*
- *u kërkon të gjejnë kryefjalën dhe të thonë se çfarë fjale është ajo, të gjejnë kallëzuesin dhe të thonë se çfarë fjale është ajo;*
- *bën pyetjet: Cilat fjalë lidhen me kryefjalën dhe e plotësojnë atë? Cilat fjalë lidhen dhe me kallëzuesin dhe e plotësojnë atë? Si quhet grupi i fjalëve i përbërë nga kryefjala dhe fjalët që e përcaktojnë? Si quhet grupi i fjalëve i përbërë nga kallëzuesi dhe fjalët që e përcaktojnë?;*
- *nxjerrin përfundimin që kryefjala dhe fjalët që e përcaktojnë atë, formojnë grupin e fjalëve të kryefjalës, që kallëzuesi dhe fjalët që e përcaktojnë atë, formojnë grupin e fjalëve të kallëzuesit;*
- *i fton të lexojnë në Librin e nxënësit tri fjalitë në vijim;*
- *u kërkon të gjejnë grupin e fjalëve të kryefjalës dhe të kallëzuesit;*
- *bën pyetjet: Cilat fjalë kryejnë funksionin e përcaktorit në këto fjali? Cilat fjalë kryejnë funksionin e rrethantorit të vendit? Cilat fjalë kryejnë funksionin e rrethantorit të kohës?;*
- *u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-9.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

4. Njoftimet publike

Synimi: të njohin nxënësit karakteristikat kryesore të teksteve profesionale dhe të aftësohen që të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të tilla, të lexojnë tekste profesionale, të dallojnë pikësytimet e këtyre teksteve, të pasurojnë fjalorin.

Janë të nevojshme : njoftime publike të llojeve të ndryshme: numërorator telefonik, orare udhëtimesh, programe televizive, meny, parashikime të motit etj.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të vështrojnë njoftimet publike që ka sjellë në klasë dhe organizon diskutimin lidhur me to;
- kërkojnë në Programin TV në ç'orë mund të ndiqen lajmet në televizion, shfaqin mendimet e tyre për programet që ndjekin, shohin disa meny dhe i krahasojnë ato, gjejnë në meny atë që duan të porositin, flasin për rëndësinë e orarit të udhëtimit dhe kërkojnë të dhënat që u duhen, njihen me mënyrën e paraqitjes së motit dhe kërkojnë të dhëna të ndryshme;
- mësuesi mund të kërkojë që dy ose më shumë nxënës të improvizojnë një dialog në restorant, duke treguar kujdes për sjelljen dhe përdorimin e shprehjeve të kulturura dhe që nxënësit e tjerë të bëjnë vlerësimin;
- u kërkon të vështrojnë në Librin e nxënësit njoftimet përkatëse (numëroratori telefonik, orari i udhëtimit etj.);
- bën pyetjet: Si quhen tekstet e mësipërme? A janë tekste letrare apo joletrare? Përse shërben numëroratori telefonik? Në çfarë rastesh duhet numëroratori telefonik? A e keni përdorur ndonjë herë orarin e udhëtimit të trenave? Kur? Ku përdoret menyuja? Çfarë përmban menyuja? Nga e merrni informacionin për kohën? Ku mund ta marrim tjetër parashikimin për motin?;
- nxjerrin përfundimin që të gjithë tekstet e mësipërme (Numëroratori telefonik, Orari i udhëtimit, Programi i TV, Menyja, Parashikimi i motit) janë njoftime publike, që njoftimet publike janë tekste joletrare;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-6.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

1. Përshkruajmë bimët

Synimi: të njohin nxënësit karakteristikat kryesore të teksteve joartistike (përshkrimi i bimëve) dhe të aftësohen të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të tilla, të aftësohen të dëgjojnë dhe të lexojnë tekste joartistike, të kuptojnë tekstet e lexuara, të gjejnë temën, fjalët kryesore, të dhënat e rëndësishme, pikësnyimet e teksteve të tilla, të sistemojnë fjalët kyçe dhe të dhënat kryesore në bllokun e fjalëve, të krahasojnë të dhënat nga teksti me ato që kanë ditur, të aftësohen të krijojnë vetë tekste të tilla sipas një rendi të caktuar (projekti, teksti bazë, korrigjimi i gabimeve, versioni përfundimtar), të zhvillojnë e ngulitin shprehitë drejtshkrimore.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *i pyet nxënësit se çfarë dinë ato për pemën e ullirit dhe organizon diskutimin për të;*
- *u kërkon të lexojnë në heshtje tekstin “Pema e paqës” dhe të gjejnë fjalët dhe të dhënat kryesore;*
- *shpjegon vetë ose në bashkëbisedim me nxënësit fjalët e vështira, në qoftë se ka;*
- *u kërkon ta lexojnë tekstin me zë;*
- *bën pyetjet: Si e ka pamjen bima e ullirit? Ç’pjesë ka ajo? Si janë rrënjët e ullirit? Si është sipërfaqja e trungut? Po gjethet si janë? Si janë lulet e ullirit? Cili është fryti i tij? Si është kokrra e ullirit? Pse teksti ka atë titull? Si mund të ishte ndryshe?;*
- *nxjerrin përfundimin që, kur duam të përshkruajmë një bimë, duhet të ndjekim një rend të caktuar dhe përgatisin skemën e përshkrimit të bimës sipas këtij rendi: lloji, pjesët, lulëzimi, fryti, ku rritet, përdorimi;*
- *u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

2. Përshkruajmë kafshët

Synimi: të njohin nxënësit karakteristikat kryesore të teksteve joartistike (përshkrimi i kafshëve), si dhe të aftësohen të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të tilla, të aftësohen të dëgjojnë dhe të lexojnë tekste joartistike, të kuptojnë tekstet e lexuara, të gjejnë temën, fjalët kryesore, të dhënat e rëndësishme, pikësynimet e teksteve të tilla, të sistemojnë fjalët kyçe dhe të dhënat kryesore në bllokun e fjalëve, të krahasojnë të dhënat nga teksti me ato që kanë ditur, të aftësohen të krijojnë vetë tekste të tilla sipas një rendi të caktuar (projekti, teksti bazë, korrigjimi i gabimeve, versioni përfundimtar), të zhvillojnë e të ngulitin shprehitë drejtshkrimore.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *i pyet nxënësit se çfarë dinë ato për luanin dhe organizon diskutimin për të;*
- *u kërkon të hartojnë një skicë - ide dhe mbi atë bazë të shkruajnë atë që dinë për luanin;*
- *u kërkon të lexojnë në heshtje në librin e nxënësit tekstin “Mbreti i kafshëve”;*
- *bën pyetjet: Çfarë kafshe është luani? Çfarë madhësie ka? Si e ka trupin, kokën, këmbët? Sa pjesë të plota ka teksti? dhe u kërkon t’i vënë një titull secilës pjesë dhe t’i shkruajnë ato në fletore;*
- *u kërkon që të ndërtojnë një tabelë me fjalët kryesore dhe të dhënat më të rëndësishme për luanin. I pyet se ku mund të kërkojnë të dhëna të tjera për këtë kafshë dhe u jep detyrë të gjejnë të dhëna të tjera;*
- *nxjerrin përfundimin që, edhe kur përshkruajmë një kafshë, duhet të ndjekim një rend të caktuar dhe përgatisin skemën e përshkrimit të kafshës sipas këtij rendi: lloji, madhësia, trupi dhe pjesët e tij, ku jeton, si jeton;*
- *u kërkon të lexojnë dhe komentojnë tekstin e nxjerrë nga enciklopedia për gjitarët;*
- *u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-4.*

Shënim. Për mësuesin po japim disa të dhëna për elefantin që t’i ketë parasysh në punën me nxënësit.

Elefanti është kafshë barëngrënëse që jeton në Afrikë e Azi. Është kafsha më e madhe në tokë. Gjatësia e tyre bashkë me feçkën arrin deri në shtatë metra, kurse lartësia deri në tri metra. Meshkujt elefantë janë të mëdhenj dhe mund të arrijnë me peshë gjer në 9071 kg. Trupi i tij është i mbuluar nga një lëkurë dy centimetra e trashë. Trupi i madh dhe i rëndë qëndron mbi katër këmbë me trashësi të njëjtë dhe të sheshta, me gishta të dalë. Koka e elefantit është e madhe dhe e rëndë. Ajo lidhet me trupin me një qafë të shkurtër. Elefantët aziatikë kanë veshë të vegjël, kurse ata afrikanë kanë veshë të mëdhenj. Ata kanë një hundë të gjatë me të cilën kryejnë një seri veprimesh. Hunda është pjesë shumë e rëndësishme e trupit të elefantit, sepse me të ai kap ushqimin, nuhat dhe merr frymë. Nga goja e elefantit dalin dy dhëmbët e sipërm prerës. Gjatësia e tyre arrin deri dy metra, kurse pesha deri 70 kg. Dhëmbët i shërbejnë elefantit për nxjerrjen e rrënjëve me të cilat ushqehet dhe si armë mbrojtëse. Elefanti femër pjell çdo vit një këlysh të vogël, të cilin e mban në bark nga 25 deri në 25 muaj. Elefantët ushqehen me bimë, me fryte të ndryshme, me gjethe, me rrënjë, me bar etj. Ata janë të fisëm dhe të butë. Elefanti konsiderohet si kafsha e katërt më e zgjuar në botë, pas shimpanzesë, balenës dhe delfinit.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

3. Emrat e lëndës dhe përmbledhës

Synimi: të gjejnë dhe të dallojnë nxënësit emrat përmbledhës dhe të lëndës, të kuptojnë karakteristikat kryesore të tyre, të aftësohen për përdorimin e drejtë të tyre në të folurit e përditshëm dhe në shkrime, të aftësohen në leximin e teksteve joartistike, të kuptojnë tekstin e lexuar, të gjejnë temën, fjalët kryesore, të dhënat e rëndësishme.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *i pyet nxënësit se çfarë dinë për qumështin dhe organizon diskutimin lidhur me këtë problematikë;*
- *u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Qumështi dhe produktet e tij”;*
- *bën pyetjet: Çfarë është qumështi? Cilat kafshë prodhojnë qumësht? Çfarë nxirret prej qumështit? Si nxirret gjalpi? Çfarë tregojnë emrat me ngjyrë të zezë? Si quhen emrat që tregojnë lëndë? A mund të përdoren në numrin shumës këta emra?;*
- *nxjerrin përfundimet që emrat që tregojnë lëndë, quhen emra të lëndës, që lënda mund të ndahet e të peshohet, po nuk mund të numërohet, që këta emra përdoren në numrin shumës vetëm kur tregojnë lloje të ndryshme të së njëjtës lëndë;*
- *u kërkon të vështrojë tabelën me emra të përgjithshëm dhe përmbledhës;*
- *bën pyetjet: Çfarë tregojnë emrat e shtyllës së parë? Çfarë emrash janë ato? Çfarë tregojnë emrat e shtyllës së dytë? Çfarë emrash janë ata? dhe u kërkon t’i shoqërojnë me numërorë dhe të thonë se çfarë vënë re;*
- *nxjerrin përfundimet që disa emra të përgjithshëm që tregojnë një grup qeniesh ose sendesh të një lloji, quhen emra përmbledhës dhe që ata nuk mund të shoqërohen me numërorë;*
- *u kërkon të lexojnë tekstin “Ajri dhe atmosfera”;*
- *bën pyetjet: Nga se është e mbuluar toka? Çfarë është atmosfera? Pse atmosfera është e domosdoshme për jetën? Nga se përbëhet ajri? Pse njerëzit kur ngjiten në mal marrin bombola oksigjeni? Pse nuk e shohim ajrin? Në cilën pjesë të atmosferës ndodhen retë ose bien rrufetë? dhe u kërkon të veçojnë emrat e lëndës;*
- *u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-4.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

4. Gjinia dhe numri i emrave

Synimi: të dallojnë dhe emërtojnë nxënësit emrat në tekste, të përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre, dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të lexojnë një tekst që ka zgjedhur vetë me kategoritë e fjalëve që kanë mësuar deri tani, emra, folje e mbiemra;
- u kërkon të gjejnë emrat, mbiemrat dhe foljet dhe t'i argumentojnë shpjegimet e tyre;
- u kërkon të shikojnë në Librin e nxënësit tabelën me emra të gjinisë mashkullore e femërore;
- bën pyetjet: Sa gjini kanë emrat? Cilët nga këta emra marrin përpara ky? Cilët nga këta emra marrin përpara kjo? Cilët emra marrin përpara ky? Në çfarë gjinie janë emrat djalë shok etj. që marrin përpara ky? Cilët emra marrin përpara kjo? Në çfarë gjinie janë emrat vajzë, shoqe etj. që marrin përpara kjo? Çfarë fjalësh përdorim si mjet ndihmës për të gjetur gjininë e emrave?;
- nxjerrin konkluzionet që emrat kanë gjininë e vet: mashkullore ose femërore, që për të gjetur gjininë e emrit, përdorim si mjet ndihmës fjalët: ky, kjo, që fjala ky është përcaktuese e gjinisë mashkullore, kjo është përcaktuese e gjinisë femërore;
- vijon me pyetjet: Çfarë tregojnë emrat djalë, vajzë, shok, shoqe? Si quhet gjinia e emrave që tregojnë qeniet e gjalla? Çfarë tregojnë emrat gur, tullë, breg, lugë? Si quhet gjinia e emrave që tregojnë sende?;
- nxjerrin përfundimet që gjinia e emrave është natyrore dhe gramatikore, që qeniet e gjalla kanë gjini natyrore, kurse sendet dhe dukuritë nuk kanë gjini natyrore;
- u kërkon të vështrojnë tabelën në vijim dhe bën pyetjen se cilët nga emrat kanë gjini natyrore dhe cilët gjini gramatikore dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- u kërkon të lexojnë një tekst që ka zgjedhur vetë me emra në numrin njëjës dhe shumës dhe organizon diskutimin për numrin e emrave;
- u kërkon të vështrojnë në Librin e nxënësit tabelën e emrave në numrin njëjës e shumës dhe organizon diskutimin për ta;
- nxjerrin përfundimin që emrat kanë dy numra, njëjësin dhe shumësin, që emri në numrin njëjës tregon një qenie ose send, që emri në shumës tregon disa qenie ose sende;
- bën pyetje: A kanë numër emrat e përveçëm? dhe u kërkon të bisedojnë për këtë gjë me shokun ose shoqen që kanë afër dhe pastaj edhe me shokët e klasës dhe u kërkon të thonë se në ç'përfundim kanë arritur;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-7.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

5. Gjinia dhe numri i mbiemrave

Synimi: të dallojnë dhe emërtojnë mbiemrat në tekste, të përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre, dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të lexojnë një tekst që ka zgjedhur vetë me kategoritë e fjalëve që kanë mësuar deri tani, emra, folje e mbiemra;
- u kërkon të gjejnë emrat, mbiemrat dhe foljet dhe t'i argumentojnë shpjegimet e tyre;
- u kërkon të shikojnë në Librin e nxënësit tabelën me mbiemra të gjinisë mashkullore e femërore dhe të nënvizojnë mbiemrat;
- bën pyetjet: Me cilat fjalë lidhen? Në çfarë gjinie janë emrat lis dhe fushë? Në çfarë gjinie janë mbiemrat i gjatë, të gjatë, e gjerë, të gjera që lidhen me to? dhe u kërkon ta argumentojnë. Bën pyetjet : Në çfarë numri janë emrat lis dhe fushë? Në çfarë numri janë mbiemrat i gjatë, të gjatë, e gjerë, të gjera që lidhen me to? dhe u kërkon ta argumentojnë. Bën pyetjen : Çfarë fjalësh përdorim si mjet ndihmës për të gjetur gjininë dhe numrin e mbiemrave?;
- nxjerrin konkluzionet që mbiemrat ashtu si emrat kanë dy gjini, mashkullore dhe femërore dhe dy numra njëjës dhe shumës, që mbiemri qëndron pranë emrit dhe ka gjininë dhe numrin e emrit pranë të cilit qëndron, që për të gjetur gjininë dhe numrin e mbiemrave përdorim si mjet ndihmës fjalët: ky, kjo, këta, këto;
- u kërkon të lexojnë tekstin “Pamje e papritur”;
- bën pyetjet: Kush është Vojsava? Ku rrinte ajo? Çfarë ndodhi papritmas? Kush ishte luftëtari që hyri?;
- u kërkon të gjejnë në tekst mbiemrat dhe të grupojnë në dy shtylla, në mbiemra të nyjshëm dhe mbiemra të panyjshëm dhe të thonë gjininë e numrin e mbiemrave që kanë gjetur;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

6. Shkallët e mbiemrave

Synimi: të dallojnë dhe të emërtojnë nxënësit shkallët e ndryshme të mbiemrave (pohore, krahasore, sipërore), të njohin veçoritë e tyre dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të lexojnë tekstin “Një nga liqenet më të vjetër në botë”;
- bën pyetjet: Ku ndodhet Liqeni i Ohrit? Çfarë thuhet në paragrafin e parë të tekstit për Liqenin e Ohrit? Nga e merr ujin Liqeni i Ohrit? Sa i vjetër është? A ka peshq në Liqenin e Ohrit? Çfarë dini për koranin dhe belushkën?;
- u kërkon të vështrojnë pllakatin “Liqeni i Ohrit dhe i Prespës” ku janë paraqitur shkallët e mbiemrit;
- bën pyetjet: Çfarë janë fjalët me shkronja të kuqe në fjalinë e parë ? Çfarë janë fjalët me shkronja të kuqe në fjalinë e dytë? Po fjalët me shkronja të kuqe në fjalinë e tretë çfarë janë? Çfarë vëren, kur i krahason fjalët me shkronja të kuqe në të tri fjalitë?;
- nxjerrin përfundimet që mbiemrat kanë tri shkallë: **pohore**, **krahasore** dhe **sipërore**, që shkalla pohore e mbiemrave tregon se dikush ose diçka ka një cilësi të caktuar, që kur duam të theksojmë shkallët e ndryshme të së njëjtës cilësi, përdorim shkallën krahasore ose sipërore;
- u kërkon të vështrojnë në Librin e nxënësit figurat në vijim;
- bën pyetjet: Në çfarë shkalle janë mbiemrat e mësipërm? Çfarë tregon shkalla krahasore: a) cilësinë e sendit, b) cilësinë duke e krahasuar, c) cilësinë në shkallën më të lartë? Po shkalla sipërore çfarë tregon: a) cilësinë duke e krahasuar, b) cilësinë në shkallën më të lartë, c) cilësinë e sendit;
- u kërkon të shënojnë shkallët e mbiemrave në tabelën që vijon;
- nxjerrin konkluzionin që shkallë kanë mbiemrat që tregojnë cilësi të drejtpërdrejtë, që mbiemrat të cilët tregojnë cilësi nëpërmjet një sendi nuk kanë shkallë;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

1. Koha e shkuar, e tashme dhe e ardhme e foljeve

Synimi: të dallojnë nxënësit kohën e shkuar, të tashme e të ardhme të foljes dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar; të aftësohen të lexojnë tekste joartistike dhe të gjejnë temën, fjalët kryesore dhe të dhënat e rëndësishme

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- I fton të flasim për organizmin e njeriut dhe mundësinë e zëvendësimit nga mjekësia të organeve të trupit të njeriut;
- bën pyetjet: A mund të zëvendësohet zemra e sëmurë? Si quhet ky veprim?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Njëqind e tetëmbëdhjetë ditë pa zemër”;
- bën pyetjet: Për se flitet në këtë tekst? Nga se vuante vajza? Sa ka jetuar vajza pa zemër? Çfarë kanë përdorur mjekët në vend të zemrës? Çfarë ka pritur vajza 118 ditë?;
- vijon me pyetjet : Çfarë janë fjalët me ngjyra? Kur kryhet veprimi i treguar nga folja shikoni? Në çfarë kohe është folja shikoni? Kur kryhet veprimi i treguar nga folja ka jetuar? Në çfarë kohe është folja ka jetuar? Kur kryhet veprimi i treguar nga folja do të përdoret? Në çfarë kohe është folja do të përdoret?;
- nxjerrin përfundimet që forma e foljes tregon zakonisht kohën e kryerjes së veprimit ose të gjendjes që ajo tregon, që forma e foljes **ka jetuar** tregon se veprimi është kryer në të shkuarën, që forma e foljes **shikoni** tregon se veprimi kryhet tani, në kohën kur flasim, që forma e foljes **do të përdoret** tregon se veprimi do të kryhet në të ardhmen;
- u kërkon që në Librin e nxënësit të plotësojnë tabelën me folje në kohën e shkuar, të tashme dhe të ardhme;
- nxjerrin përfundimin që çdo folje mund të tregojë **kohën e shkuar, të tashme dhe të ardhme**;
- u kërkon të vështrojnë në Librin e nxënësit foljet në vijim dhe të thonë se çfarë vënë re;
- nxjerrin përfundimin që foljet ndryshojnë formën sipas kohës, që foljet kanë tri kohë themelore, **të shkuarën** (kam mësuar), **të tashmen** (mësoj) dhe **të ardhmen** (do të mësoj);
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Djali i mërzitur”;
- bën pyetjet: Kë takoi fëmija në fillim? Pse u mërzi? Çfarë i thanë dallëndyshet? Kë takoi fëmija pastaj? Pse u mërzi? Çfarë i thanë drurët? Po koha çfarë i tha? Si i kuptoni ju fjalët “Koha s’ kthehet më kurrë”;
- u kërkon të gjejnë dhe të shkruajnë në fletore foljet në kohën e ardhme dhe i pyet se çfarë vënë re;
- nxjerrin konkluzionin që foljet në kohën e ardhme kanë dy forma (**do të kthehem** dhe **kam për t’ u kthyer**) dhe që të dyja format janë të drejta;
- u kërkon të shkruajnë një tekst të shkurtër se çfarë do të bëjnë të dielën që vjen;
- organizon diskutimin për shkrimin e bëra dhe verifikon përdorimin e foljeve në kohën e ardhme dhe drejtshkrimin e tyre;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

2. Përshkruajmë një krahinë

Synimi: të njohin nxënësit karakteristikat kryesore të teksteve joartistike dhe të aftësohen të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të tilla, të aftësohen të përshkruajnë një krahinë a zonë të caktuar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- i fton të flasin për vendbanimin e tyre, për pamjen, monumentet historike, pasuritë natyrore etj.;
- u kërkon të flasin për ndonjë ngjarje ose legjendë nga krahina e tyre;
- u kërkon të lexojnë në heshtje tekstin “Krahina e Rijekës”;
- bën pyetjet: *Ku gjendet krahina e Rijekës? Si është relievi i saj?? Cilat janë fshatrat e saj? Çfarë është Rijeka e Cërnojeviqe? Çfarë keni mësuar për të? Me çfarë merret popullsia e Rijekës së Cërnojeviqe? Çfarë klime ka kjo zonë? Po rrugët si janë?;*
- nxjerrin përfundimin që kur duam të përshkruajmë një krahinë duhet të ndjekim këtë rend: *pozita gjeografie, vendbanimet, monumentet historike, shtëpitë, popullsia, profesionet e njerëzve, klima dhe bimësia, komunikacioni;*
- u kërkon të bëjnë tabelën e fjalëve që shënojnë të dhënat më të rëndësishme të tekstit;
- u kërkon të gjejnë në tekst veçoritë në bazë të tabelës së fjalëve;
- u kërkon që të përcaktojnë së bashku temën ose vendin për të cilin do të shkruajnë dhe që secili të zgjedhë nga tabela problemin për të cilin do të shkruajë;
- kërkon që secili në mënyrë të pavarur të shkruajë problemin që ka zgjedhur dhe u kërkon që të respektojnë rregullat drejtshkrimore, përdorimin si duhet të shkronjës së madhe në shkrimin e emrave të vendeve etj.;
- u kërkon të lexojnë çfarë ka shkruar secili dhe të japin vlerësimet e tyre për shkrimet;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-2.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

3. Përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm

Synimi: të njohin dhe zbatojnë nxënësit rregullat bazë drejtshkrimore, të përdorin drejt shkronjën e madhe në shkrimin e emrave të fshatrave, qyteteve dhe shteteve, të aftësohen të lexojnë dhe kuptojnë tekste joartistike dhe të gjejnë temën, fjalët kryesore dhe të dhënat e rëndësishme, të pasurojnë fjalorin.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *i fton të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Mali i Zi”;*
- *bën pyetjet: Ku shtrihet Mali i Zi sot? Kur përmendet Mali i Zi për herë të parë? Cilat territore përfshinte? Cilat ishin qytetet e Malit të Zi? Kur u shpall Mali i Zi i pavarur? Cilat janë sot njësitë administrative të Malit të Zi? Cilat janë malet më të larta? Cilët janë lumenjtë dhe liqenet e Malit të Zi?;*
- *u kërkon të veçojnë nga teksti emërtimet e shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve dhe lumenjve, të vërejnë se me çfarë shkronje janë shkruar në fillim dhe të thonë se çfarë përfundimesh mund të nxjerrin;*
- *nxjerrin përfundimet që emërtimet e lumenjve, liqeneve, fushave, maleve, fshatrave, qyteteve dhe shteteve shkruhen me shkronjë të madhe;*
- *u kërkon të vështrojnë tabelën me emrat që janë nxjerrë nga teksti i mësipërm;*
- *Bën pyetjet: Çfarë emrash janë ato të kolonës së parë? Si janë shkruar emrat e kolonës së parë? Çfarë emrash janë ato të kolonës së dytë? Si janë shkruar emrat e kolonës së dytë? Çfarë dallimi vini re në shkrimin e tyre?;*
- *u kërkon të japin mendimin e tyre se pse janë shkruar në mënyra të ndryshme;*
- *nxjerrin përfundimet që kur emrat e shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve, fushave, liqeneve, lumenjve përbëhen nga dy ose më shumë fjalë, secila fjalë duhet të fillojë me shkronjë të madhe, po kur emrat qytet, fshat, mal, liqen, lumë nuk janë pjesë e emrit të përveçëm, atëherë shkruhen me shkronjë të vogël;*
- *u kërkon të shkruajnë si duhet emrat në vijim;*
- *i fton të lexojnë tekstin “Komuna e Nikshiqit”;*
- *bën pyetjet: Çfarë shënojnë emrat me shkronja të zeza? Çfarë janë emrat me shkronja të zeza? Çfarë shkronje kanë në fillim emrat e përveçëm të shteteve, qyteteve, maleve dhe lumenjve?;*
- *u kërkon të shkruajnë disa emërtime që ndodhen në krahinën e tyre dhe përreth saj;*
- *u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-4.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

4. Shkurtime

Synimi: të njohin dhe zbatojnë nxënësit rregullat bazë drejtshkrimore, të aftësohen për të shpjeguar kuptimin e shkurtimeve dhe të njohin dhe të zbatojnë rregullat për shkrimin drejt të shkurtimeve.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- *organizon diskutimin për shkurtime dhe u kërkon të thonë së cilat fjalë shkurtohen dhe përse;*
- *i fton të lexojnë në Librin e nxënësit porosinë e Lilkës;*
- *bën pyetjet: Kush e ka shkruar tekstin? Kujt i drejtohet? Për se flitet në këtë tekst?;*
- *u kërkon të vështrojnë fjalët e shkruara me shkronja të zeza dhe bën pyetjet: Çfarë ka ndodhur me to? Përse? Si quhen ato? A e dini se çfarë tregojnë? A i përdorni ju shkurtime e fjalëve? Kur?;*
- *nxjerrin përfundimet që një numër fjalësh të gjata që përdoren shpesh, shkruhen të shkurtuara sipas disa rregullave, që shkurtime mund të shkruhen me shkronja të vogla dhe të mëdha, që me shkronja të vogla shkruhen disa fjalë që përdoren shpesh, si: nr., fq., e tjerë = etj., që në këtë rast pas çdo shkurtimi vihet pikë, që shkurtime janë edhe shenjat e njësive matëse (m, kg etj.) që pas këtyre shkurtimeve nuk vihet pikë;*
- *u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-3.*

Vërejtjet e mësuesit/-es :

1. Përemrat vetorë

Synimi: të dallojnë nxënësit përemrat vetorë të vetës së parë, të dytë dhe të tretë, njëjës dhe shumës, gjininë dhe numrin e tyre dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- mbi bazën e njohurive që kanë fituar në klasat e mëparshme organizon diskutimin për përemrat vetorë;
- bën pyetjet: Sa përemra vetorë ka gjuha shqipe? Cilët janë ata? Përse shërbejnë përemrat vetorë?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësve bisedën e Zanës me Agronin;
- bën pyetjet: Kush flet? Me kë flet? Çfarë fjalësh përdor Zana në vend të emrave të fëmijëve? Po Agroni çfarë fjalësh përdor në vend të emrave të fëmijëve? Çfarë janë fjalët **unë, ai, ti, ne, ju, ata** që përdoren për të zëvendësuar emrat në këtë bisedë?;
- nxjerrin përfundimet që fjalët **unë, ti, ai / ajo, ne, ju dhe ata / ato** tregojnë persona të ndryshëm, që ata janë përemra vetorë, që përemrat vetorë tregojnë persona ose qenie të caktuara, që **unë** tregon personin që flet, **ti** personin të cilit i flitet, **ai / ajo, ata / ato** personat për të cilët flitet dhe që nuk janë të pranishëm;
- kërkon të vështojë në Librin e nxënësit tabelën e përemrave vetorë;
- bën pyetjet: Sa veta kanë përemrat vetorë? Sa numra? Sa forma ka veta e tretë për gjininë mashkullore? Sa forma ka veta e tretë për gjininë femërore?
- nxjerrin përfundimet që përemrat vetorë kanë dy numra, njëjës dhe shumës, që veta e tretë ka dy forma për secilën nga dy gjinitë, që **ai** është në gjininë mashkullore, njëjës, **ajo** është në gjininë femërore, njëjës, **ata** është në gjininë mashkullore, shumës, **ato** në gjininë femërore, shumës;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Blerta dhe dallëndyshet”;
- bën pyetjet: Cilën fjalë zëvendësojnë përemrat me shkronja të zeza? dhe u kërkon ta lexojnë pjesën, duke vënë në vend të përemrave me shkronja të zeza emrat që ata zëvendësojnë;
- i pyet se cilën mënyrë përshkrimi pëlqejnë dhe pse;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalinë në vazhdim;
- bën pyetjet: Cilën fjalë zëvendësojnë përemrat me shkronja të zeza? Si janë shkruar ato? Pse?;
- nxjerrin përfundimin që kur duam t’i drejtohem një personi me respekt dhe nderim, në vend të përemrit **ti** përdorim përemrin **Ju**, të cilin e shkruajmë me shkronjë të madhe në fillim;
- i pyet se kujt tjetër, veç mësuesit, i drejtohen me **Ju** dhe pse;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

2. Përshëndetja zyrtare dhe jozyrtare

Synimi: të njohin nxënësit tekstet zyrtare dhe jozyrtare, të dallojnë dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur përshëndetje zyrtare dhe jozyrtare, të shkruajnë drejt përemrin vetor Ju kur duan t'i drejtohen me respekt dikujt.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- kërkon të bisedojnë për kulturën e të folurit përmes pyetjesh si këto: Në çfarë rasteh përshëndeteni me të tjerët? Si përshëndeteni me shokët tuaj? Si përshëndeteni me mësuesit tuaj?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Takim me shkrimtarin”;
- bën pyetjet: Kë ka ftuar mësuesja? Kush e ka përshëndetur shkrimtarin në fillim? Si i drejtohet atij mësuesja? Pse?;
- u kërkon të lexojnë fjalët e mësueses dhe bën pyetjet: Ç’përshëndetje është ajo? Si është shkruar përemri i vetës së dytë shumës? Pse është shkruar herë me shkronjë të madhe në fillim, herë me shkronjë të vogël?;
- nxjerrin përfundimin që kur përshëndetim dikë publikisht, p.sh. në mbledhje, atëherë përshëndetje është zyrtare, që përshëndetjet zyrtare fillojnë me fjalët: **i (e) nderuar, i (e) respektuar** ose **mirëdita, mirëmbërëma, mirupafshim** etj.;
- i fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin në formë dialogu “Në dyqan”;
- bën pyetjet: Kush flet? Me kë flet? Si i drejtohet Genta shitëses? Pse? Ç’përshëndetje është ajo, zyrtare apo jozyrtare?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin në formë dialogu “Në rrugë”;
- bën pyetjet: Kë takoi Enisa? Si i drejtohet ajo Mirës? Pse? Çfarë përshëndetjeje është ajo, zyrtare apo jozyrtare? Nga se dallohen përshëndetjet e këtyre dy teksteve? Ç’përfundim mund të nxjerrim? Kujt mund t’i thoni **mirëdita, mirupafshim, mirëmbërëma, natën e mirë** dhe kujt **shëndet, çao**?;
- nxjerrin përfundimet që kur përshëndetim dikë në një takim të rastit, ose kur përshëndetim njerëz të familjes, shokë ose miq, përshëndetja është jozyrtare, që në këto raste përdorim përshëndetje si këto: **mirëdita, mirëmbërëma, tungjatjeta, çao, shëndet**, etj.;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

3. Urimi zyrtar dhe jozyrtar

Synimi: të njohin nxënësit tekstet zyrtare dhe jozyrtare, të dallojnë veçoritë e tyre dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur urime zyrtare dhe jozyrtare, të shkruajnë drejt përemrin vector Ju kur duan t'i drejtohen me respekt dikujt.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për urimet përmes pyetjesh si këto: Në çfarë rastesh dërgohen urime? Kujt i keni dërguar urime? Çfarë i keni thënë personit që i keni dërguar urimin?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit urimet e Persidës dhe të Arditit;
- bën pyetjet: Kujt i janë dërguar këto urime? Kush i ka dërguar? Me ç'rast janë dërguar? Kur është shkruar secili prej tyre? Çfarë ndryshimesh vini re ndërmjet këtyre dy urimeve?;
- nxjerrin përfundimet që urimet janë shprehje e dëshirave tona të mira për dikë, zakonisht me rastin e ndonjë feste, që ato mund të bëhen për Vitin e Ri, për ditëlindje, që këto urime fillojnë me fjalë të tilla si: **Gëzuar... ! Gjithë të mirat... !**, që mund të bëhen urime edhe për sukseset e arritura nga dikush, që këto urime fillojnë me fjalët: **Të uroj ose Ju uroj për rezultatet... !**, që urimet bëhen me gojë ose me shkrim, që urimet me shkrim duhet të përmbajnë: - vendin dhe datën e dërgimit, - emrin e marrësit, - përmbajtjen dhe - nënshkrimin e dërguesit;
- i fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin në formë dialogu “Në dyqan”;
- bën pyetjet: Kush flet? Me kë flet? Si i drejtohet Genta shitëses? Pse? Ç’përshëndetje është ajo, zyrtare apo jozyrtare?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin në formë dialogu “Në rrugë”;
- bën pyetjet: Kë takoi Enisa? Si i drejtohet ajo Mirës? Pse? Çfarë përshëndetjeje është ajo, zyrtare apo jozyrtare? Nga se dallohen përshëndetjet e këtyre dy teksteve? Ç’përfundim mund të nxjerrim? Kujt mund t’i thoni **mirëdita, mirupafshim, mirëmbërëma, natën e mirë dhe kujt shëndet, çao?**;
- nxjerrin përfundimet që kur përshëndetim dikë në një takim të rastit ose kur përshëndetim njerëz të familjes, shokë ose miq, përshëndetja është jozyrtare, që në këto raste përdorim përshëndetje si këto: **mirëdita, mirëmbërëma, tungjatjeta, çao, shëndet, etj.**;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

4. Ftesa zyrtare dhe jozyrtare

Synimi: të njohin nxënësit tekstet zyrtare dhe jozyrtare, të dallojnë veçoritë e tyre dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur ftesa zyrtare dhe jozyrtare, të shkruajnë drejt përemrin vetor Ju kur duan t'i drejtohen me respekt dikujt.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për ftesat përmes pyetjesh si këto: Në çfarë rastesh dërgohen ftesa? Kujt i keni dërguar ftesë? Çfarë i keni shkruar personit që i keni dërguar ftesë?;
- u kërkon të lexojnë ftesën që Ardita i dërgon Afërditës;
- bën pyetjet: Kush e dërgon ftesën? Me çfarë rasti është shkruar ftesa? Kush ftohet?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit ftesën e dërguar nga Biblioteka e qytetit;
- bën pyetjet: Kush e dërgon ftesën? Kush ftohet? Cili është ndryshimi midis këtyre dy ftesave?;
- nxjerrin përfundimin që ftesat mund të jenë zyrtare dhe jozyrtare, që ftesat zyrtare u dërgohen edhe personave që nuk i njohim, zakonisht me rastin e një ngjarjeje publike, që ftesat jozyrtare u dërgohen zakonisht miqve dhe të njohurve me rastin e ndonjë ngjarjeje personale;
- i fton nxënësit të bëjnë vërejtje për mungesat eventuale që mund të kenë ftesat dhe t'i plotësojnë ato si duhet;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

5. Letra personale dhe publike

Synimi: të njohin nxënësit pikësynimin dhe rëndësinë e teksteve private dhe publike dhe të dallojnë veçoritë e letrës private dhe publike dhe të aftësohen të shkruajnë në mënyrë të paruar letra personale dhe publike.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për letrat përmes pyetjesh si këto: Në çfarë rastesh dërgohen letra? Kujt i keni dërguar letra? Për çfarë arsyeje i keni dërguar? Çfarë i keni shkruar personit që i keni dërguar letër?;
- u kërkon të lexojnë në heshtje në Librin e nxënësit letrën e Mirjamit dërguar Verës;
- bën pyetjet: Kush e shkruan letrën? Kur është shkruar letra? Në cilin qytet? Kujt i drejtohet letra? Si fillon letra? Sa paragrafë ka letra? Për ç'gjë flitet në paragrafin e parë? Po në të dytin dhe të tretin? Si përfundon letra? Çfarë letre është? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen. Vijon me pyetjen se çdo të thotë P. S.;
- nxjerrin përfundimin që letra që i drejtohet vetëm një personi është letër personale;
- duke u nisur nga mënyra e plotësimit të zarfave në Librin e nxënësit organizon diskutimin për këtë problem;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit letrën që nxënësit e klasës së pestë u kanë drejtuar shokëve të tyre;
- bën pyetjet: Kush e shkruan letrën? Kujt i drejtohet letra? Si fillon letra? Për çfarë u drejtohen fëmijët shokëve të vet? Si përfundon letra? Çfarë letre është? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- nxjerrin përfundimin që letra që i drejtohet zakonisht një grupi njerëzish është letër publike;
- i fton të lexojnë letrën e shkrimtarit disident Bilal Xhaferri dhe organizon diskutimin për të;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

1. Flasim për gjuhën

Synimi: të marrin nxënësit disa njohuri për gjuhën në përgjithësi, për gjuhët që fliten sot në botë, për familjet gjuhësore dhe për vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për gjuhën përmes pyetjesh si këto: Çfarë gjuhësh fliten në Malin e Zi? Cila është gjuha juaj amtare? Çfarë gjuhe të huaj mësoni në shkollë? A flisni në shkollë si në shtëpi? Si quhet gjuha që përdorim në shkollë?;
- u kërkon të lexojnë në heshtje në Librin e nxënësit tekstin “Ç’është gjuha?”;
- bën pyetjet: Çfarë është gjuha dhe përse shërben ajo? Sa gjuhë fliten sot në botë? Cilat gjuhë kanë numrin më të madh të folësve? Në cilën familje gjuhësore bën pjesë gjuha shqipe? Sa fjalë të vjetra indoevropiane ka gjuha shqipe? dhe u kërkon të thonë disa prej tyre;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Ku flitet sot gjuha shqipe?”;
- bën pyetjet: Në cilat vende ballkanike flitet sot gjuha shqipe? Në cilën pjesë të Malit të Zi flitet gjuha shqipe? Në cilat vendE të diasporës flitet shqipja? Pse? A ka vende të tjera ku flitet shqipja? Pse?;
- u kërkon të lexojnë dhe të krahasojnë në heshtje dy tekstet në vijim;
- bën pyetjen: Me ç’gjuhë janë shkruar? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen e tyre me të dhëna nga teksti;
- u kërkon të gjejnë format joletrare në tekstin e dytë dhe bën pyetjet: Kur flisni në gjuhën letrare? Në cilat situata mund të përdorni edhe format joletrare? Përse ekzistojnë rregullat gjuhësore?;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-8.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

2. Shkrimi i emërtimeve të ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve

Synimi: të njohin dhe zbatojnë nxënësit rregullat bazë drejtshkrimore; të shkruajnë drejt shkronjën e madhe në emërtimet e ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për emrat e përveçëm përmes pyetjesh si këto: Çfarë tregojnë emrat e përveçëm? Çfarë emrash janë emërtimet e shteteve, qyteteve, fshatrave, maleve, lumenjve? Si shkruhen emrat e përveçëm?;
- u kërkon të vështrojnë tabelën me emra të përveçëm;
- bën pyetjet: Çfarë emërtojnë emrat në këtë tabelë? Si janë shkruar emërtimet e ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve në tabelën e mësipërme?;
- nxjerrin përfundimin që emërtimet e ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve shkruhen me shkronjë të madhe, me përjashtim të nyjave dhe të fjalëve shërbyese;
- u kërkon të vështrojnë tabelën në vijim me emra të përveçëm;
- bën pyetjet: Çfarë emërtojnë emrat në këtë tabelë? Si janë ndërtuar ato? Si janë shkruar emërtimet e mësipërme?;
- nxjerrin përfundimet që emrat e përgjithshëm hotel, kinema, uzinë , shkollë, fabrikë etj. që shënojnë ndërmarrje, organizata ose institucione, kur përcaktohen nga një emër i përveçëm në rasën emërore, i vënë ndërmjet thonjzash, shkruhen me shkronjë të vogël (hotel “ Adriatiku”, uzina “Drini” etj.);
- u kërkon të shpjegojnë në Librin e nxënësit shkrimin e emërtimeve të institucioneve të paraqitura në figura;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Në ekskursion” dhe të komentojnë shkrimin e emërtimeve që përmban;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-6.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

3. Numërorët

Synimi: të dallojnë nxënësit në tekste numërorët, t'i shkruajnë si duhet me fjalë dhe me shifra dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin “Pelikani”;
- bën pyetjet: Çfarë madhësie dhe peshe ka pelikani? Sa lloj pelikanësh ka? Sa vjet jeton pelikani? Sa vezë bën? Pas sa ditësh fillojnë të fluturojnë të vegjlit? Çfarë madhësie ka pelikani?;
- vijon me pyetjet: Çfarë tregojnë fjalët me shkronja të zeza? Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza?;
- nxjerrin përfundimet që fjalët që tregojnë sasi të caktuar sendesh a qeniesh janë numërorë, që numërorët shënojnë numra dhe janë pjesë e sistemit të numërimit: **një, dy, tre, katër, pesë** etj., që zakonisht numërorët shoqërohen nga fjalë të tjera;
- u kërkon që në Librin e nxënësit të lexojnë fjalitë në vazhdim dhe të vëzhgojnë përdorimin e numërorëve;
- bën pyetjen: A ndryshojnë numërorët sipas gjinisë?;
- nxjerrin përfundimin që i vetmi numëror që ka gjini është numërori **tre**, i cili kur shoqëron emra të gjinisë femërore, del në trajtën **tri**, që të gjithë numërorët e tjerë kanë të njëjtën formë për të dy gjinitë, që numërorët nuk kanë as numër, që numërori **një** përdoret vetëm me emra të numrit njëjës, kurse numërorët që nga **dy** e lart përdoren vetëm me emra në numrin shumës;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit fjalitë në vazhdim dhe të vështrojnë shkrimin e numërorëve;
- i pyet se çfarë vënë re;
- nxjerrin përfundimet që numërorët mund të shkruhen me shifra dhe me fjalë që numërorët e përngjitur shkruhen bashkë, që të ndarë shkruhen numërorët shumëfjalësh, që në bashkëvajtje me emrat numërorët nuk kanë rasë;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-6.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

4. Anketa

Synimi: të njohin nxënësit karakteristikat e teksteve joartistike dhe të aftësohen të shkruajnë vetë tekste të tilla, të njohin veçoritë e anketës si tekst joartistik, të aftësohen të plotësojnë në mënyrë të pavarur fletëanketa, të aftësohen të paraqitin rezultatet e anketave në mënyra të ndryshme.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për anketën, të thonë kur bëhet, pse bëhet, si bëhet;
- bën pyetjet: A keni marrë pjesë ndonjëherë në plotësimin e një ankete? Cili ka qenë qëllimi i anketës? A ka qenë anketimi me shkrim apo me gojë? A keni mësuar diçka prej rezultateve të anketimit?;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin dhe anketën e bërë me nxënësit e shkollës “Drita e diturisë”;
- bën pyetjet: Çfarë donte të dinte gazetari? Çfarë pyetje bëri gazetari lidhur me celularin? Çfarë është teksti i mësipërm?;
- nxjerrin përfundimet që teksti i mësipërm është një anketë, që anketa shërben për të pyetur shumë persona për një problem të caktuar, që ajo përbëhet nga pyetjet dhe nga përgjigjet, që anketimi mund të bëhet me shkrim ose me gojë;
- u kërkon të lexojnë rezultatet e anketës në tre format e paraqitjes së tyre;
- bën pyetjet: Sa forma të paraqitjes së rezultateve vini re? Cila nga këto mënyra paraqitjeje ju duket më e qartë? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- u kërkon që në grup me shokët, të hartojnë pyetjet e një ankete, të cilave do t’u përgjigjen nxënësit e klasës paralele;
- u kërkon të plotësojnë fletë-anketën në Fletoren e punës;
- u kërkon të grumbullojnë të dhënat e përfutuara dhe t’i paraqitin ato të shkruara, me tabela ose me grafik (në formë shtyllash, rrethi torte apo diagrami).

Vërejtjet e mësuesit/-es :

5. Shkrimi i titujve të librave, të revistave dhe të gazetave

Synimi: të njohin nxënësit rregullat dhe të shkruajnë drejt shkronjën e madhe në titujt e librave, të revistave dhe të gazetave.

Veprimtaritë e mësuesit/-es:

- u kërkon të bisedojnë për librat, revistat dhe gazetat, të thonë se cilat janë titujt e librave, revistave ose gazetave që preferojnë ata, çfarë kanë lexuar kohët e fundit etj.;
- u kërkon të lexojnë në Librin e nxënësit tabelën me emërtimet e disa librave, revistave e gazetave;
- bën pyetjet: Çfarë emërtojnë emrat në këtë tabelë? Si janë shkruar emërtimet e librave, revistave dhe gazetave në tabelën e mësipërme? Çfarë veçorie vini re në drejtshkrimin e dy titujve të fundit? dhe u kërkon t'i shpjegojnë përgjigjet;
- nxjerrin përfundimin që te titujt e librave, të revistave dhe të gazetave, të cilët vihen gjithmonë ndërmjet thonjzash, shkruhet me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë ("Sporti popullor") dhe emrat e përveçëm që hyjnë në përbërjen e titullit ("Historia e Skënderbeut", "Drurët dhe shkurret e Shqipërisë");
- u kërkon të shkruajnë si duhet titujt e librave të paraqitura në Librin e nxënësit;
- u kërkon të shpjegojnë titujt e librave të paraqitura në vijim;
- u kërkon të lexojnë në heshtje tekstin Sabri Godo, autor i librit « Ali Pashë Tepelena »;
- u kërkon të shpjegojnë shkrimin e emërtimeve të librave në tekstin Sabri Godo, autor i librit « Ali Pashë Tepelena »;
- u kërkon të bëjnë në Fletoren e punës ushtrimet 1-5.

Vërejtjet e mësuesit/-es :

ZGJIDHJET E USHTRIMEVE TË FLETORES SË PUNËS

KAPITULLI I PARË

1. Bisedat zyrtare dhe jozyrtare

1.

a) Zhvillohet ndërmjet dy personave që nuk njihen.

Bashkëbiseduesit i drejtohen njëri-tjetrit me *Ju*.

Gjuha është e zgjedhur.

b) Zhvillohet ndërmjet dy personave që njihen

Bashkëbiseduesit nuk i drejtohen njëri-tjetrit me *Ju*.

Gjuha është e çlirët.

2.

A.

1. Ardita dhe Berti

2. he, çao

3. vizita në Galerinë e arteve

4. jozyrtare

B.

1. një qytetar, punonjësi i Postës

2. mirëdita, mirëdita

3. me Ju

4. dërgimi i një letre në Francë

5. zyrtare

3.

a)

ZYRTARISHT : me shitësin e këpucëve, me nënën e shokut, me gjyshen fqinje me mësuesen e kulturës fizike, me punonjësin e sportelit të Postës, me mjekun

JOZYRTARISHT : me nxënësin kujdestar, me dajën që ke kohë pa e parë

2. Fjalitë sipas kuptimit, formës dhe ndërtimit

1.

a) Fëmijët po luanin.

b) Fëmijët po luanin me njeri-tjetrin në parkun e qytetit.

2.

1) pyetëse pohore e thjeshtë

2) dëftore mohore e zgjeruar

3) nxitëse pohore e zgjeruar

3. Funkzioni i fjalëve në fjali

1.

a) kush e kryen veprimin

b) çfarë bën kryefjala

2.

1) Mjeda, emër

- 2) Kotorri , emër
 - 3) Ai , përëmër
 - 4) Ai , përëmër
 - 5) Andrra e Jetës, grup emëror
- 3.
- 1) më 1866 (rrethanor kohe), në Shkodër (rrethanor vendi)
 - 2) në atë kohë (rrethanor kohe)
 - 3) në Spanjë, Itali, Francë (rrethanorë vendi)_
 - 4) bukur (rrethanor mënyre)
 - 5) në vëllimin “Juvenilia” (rrethanor vendi)
- 4.
- 1) është kryevepra e tij, jam + grup emëror
 - 2) u botua, folje
 - 3) dolën, folje
- 5.
- 1) nuk ka rrethanor
 - 2) për së gjalli (rrethanor kohe)
 - 3) pas vdekjes (rrethanor kohe)
- 6.
1. **lindi** Ndre Mjeda
 2. A “Juvenilja” është vepra
- 7.
- 1) Gegë e toskë **janë vëllezër**
 - 2) Gjuha , është shqipja
 - 3) Gjuha është si zëri
 - 4) gjuhët **janë të bukura**
- 8.
- 1) jam+emër.
 - 2) jam+emër
 - 3) jam+emër
 - 4) jam+mbiemër
- 9.
- 1) dje
 - 2) në ballkon
 - 3) me kujdes

4. Njoftimet publike

1.
 - a) meny
 - b) orar udhëtimesh
 - c) program televiziv
 - d) parashikimi i motit

KAPITULLI I DYTË

1. Përshkruajmë bimët

1.

1. ulli
2. rrënjët, trungu, degët, gjethet, lulet, fryti
3. prill-qershor
4. të vogla të bardha në krem
5. i rrumbullakët ose në formë vezake
6. në vende të ngrohta
7. druri për orendi, kokrra për vaj

2.

degët dhe gjethet
trungu
rrënjët

3.

- | | |
|-----------------|--|
| 1. kurora | është me gjelbërim të përhershëm, me gjethe dimër-verë |
| 2. trungu/druri | me lëkurë të lëmuar dhe me ngjyrë të hirtë në të gjelbër. |
| 3. gjethet | janë të ngushta e në formë heshte, me ngjyrë të gjelbër të errët. |
| 4. lulet | janë të vogla, të bardha në krem dhe me erë të këndshme |
| 5. rrënjët | ndodhen në 20-30 cm thellësi, një pjesë e vogël në 60 cm dhe vetëm shumë pak shkojnë deri në 100-120 cm. |

4.

- a) 3, 2, 1, 5, 4, 6
- b) për blirin
- c)

Blirri

Është një pemë e madhe deri në 40 metra e lartë. Gjethet i ka në formë zemre dhe të madhësive të ndryshme. Ato janë me push të imët dhe me deje. Lulet janë të bardha dhe me një aromë shumë të këndshme. Ato nga mjekësia popullore përdoren si çaj kundër kollës dhe si qetësues i dhembjeve të stomakut. Lulëzon në qershor-korrik. Druja e tij është e bardhë, e lehtë dhe e butë. Përdoret për gdhendje. Mbillet shpesh në të dyja anët e rrugëve të qyteteve, sepse lulet e tij në qershor, kur lulëzojnë, lëshojnë një aromë të këndshme.

2. Përshkruajmë kafshët

1.

1. kafshë e egër gjitare
2. gjatësia 1.75-2,5 metra, pesha 150-225 kilogramë
3. është i zgjatur dhe me muskuj të fuqishëm
4. në Afrikë dhe në Azi
5. në kope

2.

koka (veshët, sytë, hunda, goja)
qafa
trupi
bishti
këmbët

3.
a) 1, 4, 3, 5, 2
b) për macen

4.
a)
1. kafshë barngrënëse
2. 7 i gjatë, 3 metra i lartë, pesha, 9071 kilogramë
3. trup të madh, këmbë të trasha, kokë të madhe, veshë të mëdhenj ose të vegjël, hundë të gjatë
4. në Afrikë dhe në Azi
5. ushqehet me bimë dhe me fruta

3. Emrat e lëndës dhe përmbledhës

1.
a) emra të lëndës
b) emra përmbledhës
c) e njëjësit

2

Emra të lëndës	Emra përmbledhës
djathë, benzinë, grurë, gjizë, salcë, hurrë, mazë, baltë, qymyr, kos, dhallë, thekër, gjalpë, tëlyen, vajguri	djalëria, rinia, graria, pleqëria, fshatarësia, vajzëria, njerëzimi, fëmija

4.
oriz, gjalpë, lëng, mish, ujë, kripë, sheqer, kanellë, karafil

4. Gjinia dhe numri i emrave

1.
lepur, dhelpër, qen, mace, dash, dele, ujk, rosë

2.

Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
lepur qen dash ujk	dhelpër mace dele rosë

3.

Emrat	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
	natyrore	gramatikore	natyrore	gramatikore
gjysh	+		+	
teze				+
shtëpi				
nip	+			
zonjë			+	
gazetare			+	
libër		+		
mjek	+			
pulë			+	
domate				+
dash	+			

4.

djalë, mjeke, lapës, nxënëse

5.

arrë, topa, veturë, libra, këmishë, çekiçë

6.

Emrat	Çfarë tregojnë	Gjinia	Numri
arrë	send	femërore	njëjës
topa	sende	mashkullore	shumës
veturë	send	femërore	njëjës
libra	sende	mashkullore	shumës
këmishë	send	femërore	njëjës
çekiçë	sende	mashkullore	shumës

7.

Çapaçuli *m. nj.*; helikopter *m. nj.*; ditë *f. nj.*, daja *m. nj.*; pilot *m. nj.*; qejf *m. nj.*; toka *f. nj.*; era *f. nj.*; anët *f. sh.*; fletët *f. sh.*; shtrëngatë *f. nj.*; shtëpitë *f. sh.*; kuti *f. nj.*; shkrepsesh *f. sh.*; kafshët *f. sh.*; miza *f. nj.*; rrugët *f. sh.*; vija *f. nj.*; herë *f. nj.*; tokën *f. nj.*; mrekulli *f. nj.*

5. Gjinia dhe numri i mbiemrave

1.

emra: *mik, vëlla, shpejtësi, gjallëri, gëzim, mërzi, shkollë*

mbiemra: *miqësor, vëllazëror, i shpejtë, i gjallë, i gëzuar, gazmor, i mërzitur, shkollor, i shkolluar*

2.

të nyjshëm : *i lezetshëm, i bardhë, i madh, i vogël, i egër, i thyer, i tepërt, i mirë*

të panyjshëm : *fillor, leshzi*

3.

emrit

4.

Mbiemri	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
vajzë trime		+
mal i lartë	+	
dhelpër dinake		+
shtëpi e bukur		+
djalë i shkathët	+	
nxënës shembullor	+	
tokë e punuar		+

5.

Mbiemri	Numri njëjës	Numri shumës
vajzë trime	+	
mal i lartë	+	
dhelpër dinake	+	
shtëpi të bukura		+
djalë i shkathët	+	
nxënës shembullorë		+
toka të punuara		+

6. Shkallët e mbiemrit

1.

b)

2.

1. më e vogël
2. më e madhe
3. më e madhe
4. më e vogël
5. shumë e vogël
6. shumë e madhe

3.

Shkalla pohore	Shkalla krahasore	Shkalla sipërore
i mirë	më i mirë	shumë i mirë
i shkathët	më i shkathët	shumë i shkathët
i gëzuar	më i gëzuar	shumë i gëzuar
guximtar	më guximtar	shumë guximtar
i pastër	më i pastër	shumë i pastër
i sjellshëm	më i sjellshëm	shumë i sjellshëm
i bukur	më i bukur	shumë i bukur

4.
dimëror, tokësor, malor, diellor

KAPITULLI I TRETË

1. Koha e shkuar, e tashme dhe e ardhme e foljeve

2.
do të lexoj, hëngra, kam shëtitur
3.
a) do të mësoj, do të luaj
b) kam për të mësuar, kam për të luajtur
- 5.

Foljet	Koha e shkuar	Koha e tashme	Koha e ardhme
dëgjon, ke lënë ka mori	+ +	+ +	
do të marrim do të zbresim lind		+ +	+ +
do të vritet zbritën ishin nisur ktheheshin kishte mbetur	+ + + +		

2. Si të përshkruajmë një vend?

1. a.



3. Përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm

3.

Gadishulli Ballkanik, liqeni i Shkodrës, liqeni i Plavës, Boka e Kotorrit, Sllovakia, Britania e Madhe, Republika Çeke, liqeni i Shasit, Bjeshkët e Nemuna

4. Shkurtime

2.

Shkurtime	Shkurtime
BE	dt
KE	fig.
SHBA	km
MZ	g
MPJ	lit.
ASH	m
UP	min.
IGJL	shek.

2.

P.R.

R.T.M.

A GJ Fishta

prof

kg.

3.

3-4 cm (centimetër)

30-40 cm (centimetër)

p.sh. (për shembull).

fig. (figurën) poshtë.

KAPITULLI I KATËRT

1. Përemrat vetorë

1.

Unë - Veta e parë, njëjës

Ti - Veta e dytë, njëjës

Ai/ ajo - Veta e tretë, njëjës

Ne - Veta e parë, shumës

Ju - Veta e dytë, njëjës

Ata/Ato - Veta e tretë, shumës

2.

Artani iu përgjigj Shpresës se ai e kishte mësuar notin që tre vjeç.

Shpresa e pyeti Artanin se ku kishte lindur ai.

Artani iu përgjigj se ai kishte lindur në Kollashin.

3.

Ti dhe ajo keni shumë gjëra të përbashkëta.

Ku jeton ajo.
Ato kanë marrë nota të mira.
Ne do të kthehemi vonë.
Ku shkoi ai?
Kur do të vijnë ato?

4.
ju, Bibliotekës së Shkollës.

2. Përshëndetja zyrtare dhe jozyrtare

1.
njerëz të familjes, shokë ose miq.
2.
gjithë të tjerët
3.
Mirëdita zoti drejtor/ zonja drejtoreshë!, Mirupafshim zoti drejtor!
4.
Mirëdita! Mirupafshim!
5.
Tungjatjeta! Përshëndetje! Çao! Shëndet!
6.
Mirupafshim mësuese!

3. Urimi zyrtar dhe jozyrtar

1.
 - a) urim për fitoren e konkursit
 - b) urim për Vitin e Ri
2.
 1. redaksia e gazeta "Vijesti"
 2. abonentëve të gazetës
 3. festa e pavarësisë
 4. urim zyrtar
 5. ditëlindja
 6. vajza
 7. nënës
 8. jozyrtar
 9. urimet jozyrtare u dërgohen njerëzve të njohur, kurse urimet jozyrtare njerëzve të panjohur.
3.
 - vendin dhe datën e dërgimit,
 - emrin e marrësit,
 - përmbajtjen
 - nënshkrimin e dërguesit.

4. Ftesa zyrtare dhe jozyrtare

1.
 - 1) Ambulanca e Ulqinit
 - 2) Zotin: Gjergj Shllaku
 - 3) Me rastin e përrurimit të ambulances
 - 4) Ditën e hënë me 20 tetor
 - 5) Ftesë zyrtare

2.
 - a) zyrtare
 - b) emri i shkollës, vendi ku organizohet festa

5. Letra personale dhe publike

1.

letrat personale

- 2.**
 - 1) shkrimtari Bilal Xhaferi
 - 2) kushëririt të tij, Edipit
 - 3) I dashur Edip
 - 4) Letra ka dy paragrafë.
 - 5) I kërkon falje që nuk arriti dot t'i kthente pantallonat që i kishte marrë.
 - 6) I jep disa porosi për Halilin dhe e njofton se është shtruar në spital.
 - 7) Të bëj shumë të fala
 - 8) Letër personale

3.
 - 1) nxënësit e klasës së pestë
 - 2) të gjithë nxënësve të shkollës
 - 3) letra është publike

KAPITULLI I PESTË

1. Flasim për gjuhën

1.

Rreth 6700 gjuhë

2.

225 gjuhë

3.

Në familjen e gjuhëve indoevropiane

4.

italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, gjermanishtja, anglishtja, norvegjishtja, rusishtja, polonishtja, serbishtja, lituanishtja, letonishtja, greqishtja etj.

5.

Familjes së gjuhëve indoevropiane

6. në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore, në Serbinë Jugore, në pjesën jugperëndimore të Malit të Zi dhe në Çamëri,
7. në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë
8. Gjuha që flitet në punë, radio televizion, në shkollë etj. sipas disa rregullave të caktuara.

2. Shkrimi i emërtimeve të ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve

1.
 - a) të madhe, të nyjave, fjalëve shërbyese
 - b) i përveçëm, emërore, të madhe
5.
 - a) Banka qendrore e Malit të Zi
 - b) Fakulteti i historisë dhe i filologjisë
- a) Banka Qendrore e Malit të Zi
- b) Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
6.
 1. Fabrika e Këpucëve Shpresa
 4. sheshi i Flamuri
 7. Kinema “Morava”
1. fabrika e këpucëve “Shpresa”
2. Sheshi i Flamurit
3. Kinema “Morava”

3. Numërorët

2. trembëdhjetë, katërbëdhjetë, njëzet e një, tetëdhjetë, gjashtëdhjetë e shtatë, dyqind e tridhjetë e shtatë
4. katër, dymbëdhjetë, tridhjetë e një, njëzet e tetë
5.

13-5-2009	12/9/2009	15-X-2009
13.5.2009	12.9.2009	15. X. 2009
6. njëzetegjashtë, tetëdhjetë e tetë, gjashtë, katër, dy

5. Shkrimi i titujve të librave, revistave dhe gazetave

1.
 - a) të madhe
 - b) e përveçëm

- 4.
1. “Bagëti e Bujqësia”
2. “Gramatika e Gjuhës Malazeze”
4. Studime Filologjike

1. “Bagëti e bujqësia”
2. “Gramatika e gjuhës malazeze”
4. Studime filologjike

CIP – Каталогizacija u publikaciji
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

37.016:811.18 (075.2)

BECI, Bahri

Flashim dhe hartojmë njohim gjuhen : gjuha shqipe 5: për klasën e pestë të shkollës fillore nëntëvjeçare: libri i mësuesit/Bahri Beci; – Podgoricë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2009 (Podgorica: Studio Mouse). – 36 str.: ilustr.; 29 cm

Tiraž 50.

ISBN 978–86–303–1417–9

COBISS.CG-ID 14428432